



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE”

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të komisionit të ankimimeve dhe sanksioneve”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 16, pika 6, neni 20, pika 1 germa “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të nenit 16, pika 6, dhe neni 20, pika 1, germa “d” të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



Nr. 03 i Vendimit

Data 06.11.2020 e Vendimit

Ora 10:00 e Vendimit

Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”

## VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ilijana NANO -**

**Kryetare**

**Arens ÇELA -**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA -**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ -**

**Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ -**

**Anëtar**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

RREGULLORE

PËR

MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT  
TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Në mbështetje të nenit 16, pika 6, nenit 20, pika 1, gërma “d”, nenit 21 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Rregullator vendosi:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe objekti i rregullore**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (më poshtë KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (më poshtë “KQZ”), dhe zhvillimi i seancave të KAS në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (“KAS”), duke përfshirë:

- a) mënyrën e ushtrimit të kompetencave të anëtarëve të KAS-it;
- b) procedurat për thirrjen, njoftimin dhe zhvillimin e seancave të KAS-it;
- c) procedurat e vendimmarrjes të KAS-it;
- ç) të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe palëve në procesin e ankimit;
- d) rregullat mbi koordinimin e veprimtarisë administrative të KAS-it me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Administratën e KQZ-së.

**Neni 2**

**Ligji dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

1. Veprimtaria e KAS-it mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile” i ndryshuar në ligje dhe akte nënligjore të veçanta që lidhen me veprimtarinë e KQZ, si dhe në aktet e miratuara nga vetë KQZ.





2. Veprimtaria e KAS bazohet edhe në parimet kushtetuese, parimet e Kodit Zgjedhore dhe parimet e parashikuara në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

## KREU II PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

### Neni 3

#### Përbërja e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve është organ kolegjal, i përbërë nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen sipas procedurave të parashikuara në nenet 12 dhe 16 ligjit nr. ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

### Neni 4

#### Kompetencat e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

1. KAS-i ushtron këto kompetenca:

- a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjeshme ose të plotë të zgjedhjeve;
- b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit;
- c) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ve;
- ç) vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve për çështjet që shqyrton;
- d) me kërkesë të Komisionerit vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit a posteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim;
- dh) me kërkesë të Komisionerit vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

2. Secili anëtar i KAS-it ka të drejtë që gjatë hetimit administrativ të marrë kryesisht, pa debat dhe as votim, prova që janë në administrim të KQZ-së.

3. Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit sipas shkronjave “a”, “b” ose “c” të pikës 1, kur objekt i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë.



**Neni 5**  
**Të drejtat e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

1. Të drejtat e anëtarit të KAS burojnë nga neni 16 dhe 21 i Kodit Zgjedhor dhe ligje të tjera. Çdo anëtar i KAS-it për ushtrimin e funksioneve të veta ka dhe këto të drejta:
- a) t'i kërkojë çdo informacion, dokumentacion dhe mbështetje administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin të vërë në dispozicion sipas kërkesës, kopje të çdo dokumentacioni të depozituar në KQZ;
  - b) t'i sigurohen nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kushtet për zhvillimin e seancave të KAS-it; të njihet me rendin e çështjeve që do të shqyrtohen në seancat e KAS në përputhje me afatet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë rregullore.

**Neni 6**  
**Detyrat e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet:

- a) të mos ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera brenda organeve, institucioneve apo enteve, pjesë e pushtetit ekzekutiv;
- b) të zbatojnë dhe të respektojnë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje.

**Neni 7**  
**Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, Komisioni të Ankimimeve dhe Sanksioneve asistohet dhe mbështetet nga administrata e KQZ-së .

**KREU III**  
**FUNKSIONIMI I SEANCAVE DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË**  
**ÇËSHTJEVE NGA KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

**Seksioni 1**  
**E DREJTA E ANKIMIT, FORMA DHE PËRMBAJTJA E ANKIMIT**

**Neni 8**  
**Kryerja e veprimeve procedurale**

Veprimet procedurale të KAS-it, kryhen në përputhje me ligjin 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij, me ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.





## Neni 9 E drejta e ankimit

1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtën e ankimit në KAS kundër vendimeve të KZAZ-së, që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore nën juridiksonin e saj, të marrë sipas nenit 122 të Kodit Zgjedhor, mund të paraqitet ankimi në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

3. Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të Kodit Zgjedhor, mund të paraqitet ankimi në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të ketë si objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.

5. Të drejtën e ankimit sipas pikës 1 të këtij neni e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në nenin 6 të Kodit Zgjedhor, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve.

6. Në shqyrtimin e ankimeve të paraqitura, KAS-i shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

7. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias, kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin e vëzhguesve brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

8. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankimi në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstronin një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit.





**Neni 10**  
**Forma dhe përmbajtja e ankimit që i drejtohet Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve**

1. Kërkesa ankimore paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të kërkesës sipas modelit të aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikon në faqen zyrtare formularin standard të kërkesës ankimore.

2. Kërkesa ankimore duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementët e mëposhtëm:

a) Të dhënat identifikuese të ankuesit përfshirë adresën postare, adresën e postës elektronike dhe/ose numrin e telefonit;

b) Objektin e ankimit. Në rastin e kërkesës për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi duhet të përcaktojë edhe njësinë zgjedhore dhe / ose qendrat e votimit të kontestuara;

c) Identifikimin aktit për të cilin Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, apo KZAZ-ka patur detyrimin të nxjerrë.

ç) Përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe pasojat e tyre;

d) Faktet, argumentet, dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi;

dh) Tregimin e provave që paraqiten, që kërkon të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, burimin e tyre si edhe numrin e tyre;

e) Datën dhe nënshkrimin nga subjekti ankues ose përfaqësuesi i autorizuar i tij.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve përmban, për aq sa është e mundur, elementët e parashikuar në këtë pikë.

4. Ankuesi duhet të depozitojë, së bashku me ankimin, edhe vendimin e plotë, ndaj të cilit ushtron ankimin, me përjashtim të rastit kur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe KZAZ-ja nuk merr vendim.

**Seksioni 2**  
**PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË ANKIMEVE DHE SHORTI**

**Neni 11**  
**Regjistrimi i Ankimeve Administrative**

1. Kërkesa ankimore drejtuar KAS-it depozitohet dhe regjistrohet menjëherë në Regjistrin e Ankimeve administrative nga struktura përgjegjëse pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përputhje me nenin 127 të Kodit Zgjedhor. Me regjistrimin e ankimit administrativ, një kopje i dërgohet menjëherë Komisionerit dhe KAS-it. Komisioneri vë në lëvizje KAS-in nëpërmjet njoftimit të tij mbi ankimin administrativ dhe njofton Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ.

2. Regjistri i Ankimeve administrative përmban:

a) numrin rendor të ankimit;

b) datën dhe orën e paraqitjes së ankimit;

c) subjektin ankues;

d) objektin e ankimit;

dh) listën e dokumenteve që i bashkëlidhen ankimit.

3. Pas bërjes së shënimeve në regjistër, subjekti që ankohet merr nga KQZ-ja një vërtetim, i cili provon dorëzimin dhe marrjen e kërkesës ankimore.





4. KQZ-ja nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e kërkesave ankimore.

5. Regjistri i Ankimeve Zgjedhore është vetëm për zgjedhjet e radhës. Hapja e Regjistrimit të Ankimeve Zgjedhore për zgjedhjet e radhës bëhet jo më vonë se 24 orë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Në këtë regjistër shënohen edhe kërkesat ankimore për zgjedhjet e pjeshme që zhvillohen midis dy zgjedhjeve të përgjithshme.

#### Neni 12

#### Caktimi i seancës për përgatitjen e shortit

1. Brenda 8 orëve nga momenti i regjistrimit të ankimimit administrativ/sanksioneve/masa, Komisioneri vë në lëvizje nëpërmjet njoftimit KAS-in dhe lajmëron anëtarët e tij për datën, orën dhe rendin çështjeve për të cilat do të hidhet shorti për caktimin e relatorit/relatorëve/.

2. Njoftimi sipas paragrafit 1 hartohet në tre kopje, nënshkruhet nga Komisioneri dhe regjistrohet në protokoll.

3. Menjëherë pas regjistrimit në protokoll, Njoftimi sipas paragrafit 1 të këtij neni i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e Komisioneri, KAS-it, përfaqësuesve të partive politike dhe sipas rastit edhe palët e treta.

4. Kopje e njoftimit të seancës vendoset në vendin e posaçëm në hyrje të KQZ-së, si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së në internet.

5. Procesi i hedhjes së shortit zhvillohet nga administrata e KQZ nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm.

6. Hedhja e shortit bëhet brenda 12 orëve nga çasti i regjistrimit të kërkesës ankimore.

#### Neni 13

#### Vetëmbledhja e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe caktimi i seancës për përgatitjen e shortit

1. Në rast se Komisioneri nuk kryen procedurën e parashikuar në pikën 1 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, atëherë anëtari i KAS-it ka të drejtën të thërrasë seancën për hedhjen e shortit. Në rast se ka më shumë se një njoftim për thirrjen e seancës së shortit, kërkesa e depozituar e para merr përparësi. Njoftimi parashikon datën, orën dhe rendin e çështjeve për të cilat do të hidhet shorti për caktimin e relatorit/relatorëve menjëherë nga përfundimi i afatit të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12, njoftimi i seancës sipas paragrafit 1 hartohet në tre kopje, nënshkruhet nga thirrësi dhe regjistrohet në protokollin e KQZ-së. Menjëherë pas regjistrimit në protokoll, njoftimi i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e Komisionerit, KAS, përfaqësuesve të partive politike dhe sipas rastit palët e treta.

2. Kopja e njoftimit të thirrjes së seancës vendoset në vendin e posaçëm në hyrje të KQZ-së, si dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së në internet.

3. Procesi i hedhjes së shortit zhvillohet nga administrata e KQZ-së nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Hedhja e shortit bëhet brenda 12 orëve nga çasti i regjistrimit të kërkesës ankimore.





## Neni 14

### Zhvillimi i Shortit për caktimin e relatorit për ankimet administrative dhe kërkesat për masa dhe sanksione

1. Procesi i hedhjes së shortit zhvillohet në seancë publike, nga administrata e KQZ-së nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm, në prani të anëtarëve të KAS-it, përfaqësuesve të subjektit/subjekteve ankimuese, Komisionerit sipas rastit, subjekteve të tjera që kanë interes legjitim për çështjen dhe përfaqësuesve të mediave.

2. Për çdo ankim administrativ të regjistruar/kërkesë, caktohet si relator një prej anëtarëve të KAS-it.

3. Procedura e shortit ndjek këtë rend:

a) Sekretari i Përgjithshëm i KQZ -së publikon në këndin e njoftimeve të KQZ-së si dhe në faqen web, datën dhe orën e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit të ankimeve/kërkesave të depozituara për të cilat do të hidhet shorti në rend kronologjik sipas kohës së paraqitjes tyre, duke nisur nga ato të regjistruara më herët. Në rast se depozitohen deri në pesë ankime administrative/ kërkesa, Drejtoria Juridike e KQZ-së, përgatit 5 shirita letre si dhe 5 gogla të së njëjtës ngjyrë jo transparente, pa shenja apo shënime, dhe të së njëjtës peshë dhe madhësi. Numri i shiritave të plotësuar përkon me numrin e ankimeve administrative/ kërkesave. Shiritat e plotësuar përmbajnë numrin e ankimit administrativ/ kërkesës, subjektin (shkronjat nistore) dhe objektin e ankimit/kërkesës. Shiritat e tjerë janë të bardhë, pa shënime.

b) Në rast se depozitohen më shumë se 5 ankime administrative/ kërkesa, Drejtoria Juridike e KQZ-së përgatit aq shirita letre që përkojnë me numrin e ankimeve administrative/ kërkesave si dhe numër të njëjtë të goglave të së njëjtës ngjyrë jo transparente, pa shenja apo shënime, dhe të së njëjtës peshë dhe madhësi. Shiritat e plotësuar përmbajnë numrin e ankimit administrativ/ kërkesës, subjektin (shkronjat nistore), dhe objektin e ankimit.

c) Më pas një përfaqësues i administratës së KQZ-së i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, në prani të anëtarëve të KAS dhe pjesëmarrësve të pranishëm në sallë, prezanton shiritat dhe, pasi i palos ato, vendos secilin prej tyre në goglat përkatëse.

ç Përfaqësuesi i ngarkuar, përzier goglat në një enë transparente dhe më pas, Anëtarët, sipas rendit alfabetik **ngjites** të emrit, tërheqin një nga goglat që ndodhen në enë.

d) Me përfundimin e raundit të parë të tërheqjes së goglave, në raundin e dytë anëtarët sipas rendit alfabetik **zbritës** do të tërheqin një nga goglat që ndodhen në enë deri në shterimin e tyre.

dh Anëtari që përzgjedh goglën që mbart shiritin me numrin e ankimit administrativ/ kërkesës, do të jetë relatori i ankimit administrativ/ kërkesës. Në rast se, për arsye objektive, një ose disa nga anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm në seancën e hedhjes së shortit, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ tërheq goglën/goglat në emër të tij/tyre.





4. Administrata e KQZ-së bën publike rezultatin e shortit duke renditur ankimet administrative/kërkesat në rend ngjitës si dhe duke përcaktuar relatorin përkatës për secilën prej tyre.

5. Relatori i përzgjedhur për shqyrtimin e ankimit administrativ/kërkesës së parë në renditje është përgjegjës për organizimin e seancës vijuese ku do të bëhet shqyrtimi i ankimeve administrative/kërkesave të shortuara sipas parashikimeve të këtij neni.

## **KREU IV**

### **PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE ADMINISTRATIVE, DHE KËRKESAVE TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

#### **Seksioni 1**

#### **PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE ADMINISTRATIVE NGA KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

##### **Neni 15**

##### **Rendi i ditës**

1. Relatori i çështjes, i caktuar sipas pikës 5 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, njofton seancën e KAS-it duke përcaktuar datën, orën, rendin e ditës për shqyrtimin e kërkesave ankimore të shortuara sipas pikës 4 të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

2. Në rendin e ditës duhet të përfshihen vetëm çështjet për të cilat është hedhur shorti. Për ekonomi administrative, në rendin e ditës mund të përfshihet edhe hedhja e shortit për ankesat ankimore/kërkesat të depozituara para zhvillimit të seancës.

3. Njoftimi për thirrjen e seancës sipas pikës 1, të këtij neni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga relatori përkatës. Njoftimi regjistrohet në protokollin e KQZ-së.

4. Njoftimi i thirrjes së seancës, menjëherë pas regjistrimit në protokoll, i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, i cili merr masa për njoftimin e Komisionerit, KAS-it, përfaqësuesve të partive politike dhe sipas rastit dhe palëve e treta.

##### **Neni 16**

##### **Përjashtimi**

1. Anëtari i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nuk mund të jetë relator dhe nuk merr pjesë gjatë shqyrtimit dhe në vendimmarrjen mbi një ankim administrativ/kërkesë, kur ai gjendet në një nga rastet e pengesave ligjore të parashikuara në nenin 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, apo të konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2. Nëse anëtari i KAS-it vëren një nga pengesat e parashikuara pikën 1 të këtij neni, ai njofton menjëherë me shkrim KAS-in.

3. Çdo zyrtar tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30 të Kodit Procedurave Administrative, njofton KAS-in.





4. Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtarit të KAS-it nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet KAS-it dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

5. KAS-i, i njoftuar sipas parashikimeve të këtij neni, merr vendim në seancë përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit.

6. Në rast se KAS-i vendos përjashtimin e anëtarit procedura administrative vazhdon pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar.

### Neni 17

#### Verifikimi i plotësimit të formës dhe përmbajtjes së ankimit

1. Seanca e verifikimit të elementëve të formës dhe përmbajtjes të ankimeve administrative/kërkesave drejtohet nga relatorët e shortuar sipas parashikimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje, me radhë, në përputhje me renditjen e bërë publike, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

2. Gjatë seancës, relatori bën verifikimin e ekzistencës së elementëve të formës, sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementëve të përcaktuara në nenin 129 dhe nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Rezultati i verifikimit relatohet në mbledhjen e KAS-it jo më vonë se 24 orë nga çasti i regjistrimit të ankimit.

3. KAS-i bën verifikimin paraprak të ankimit administrativ dhe vendos:

- a. kalimin e ankimit për shqyrtim;
- b. mospranimin e ankimit për shkak të mungesës së elementëve të përcaktuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor; ose
- c. kthimin e ankimit për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor.

4. Në rastin e parashikuar në shkronjën “c” të pikës 3 të këtij neni, ankuesi bën plotësimin e ankimit dhe e ridepoziton atë brenda 24 orëve nga çasti i shpalljes së këtij vendimi.

5. Ankimi administrativ mund të kthehet për plotësim vetëm një herë. Verifikimi i dytë i Ankimit administrativ kryhet brenda 24 orëve nga ridepozitimi i tij.

### Neni 18

#### Objekti i verifikimit paraprak

1. KAS-i merr vendim për pranimin ose mospranimin e ankimit administrativ/kërkesës pasi verifikon elementet e mëposhtme:

- a) kompetencën e KAS-it për shqyrtimin e ankimit;
- b) legjitimitimin e ankuesit; dhe
- c) respektimin e afateve ligjore për ankimin.

2. Në vendimin e pranimit për shqyrtim të ankimit administrativ, relatori përkatës duhet të përcaktojë datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në seancë publike. Vendimi afishohet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se 2 orë pas marrjes së tij.





3. Seanca e shqyrtimit zhvillohet jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 48 orë nga data e shpalljes së vendimit të pranimit.

### Neni 19

#### Bashkimi i ankimeve administrative dhe shqyrtimi administrativ

1. Shqyrtimi i ankimeve administrative ndaj rezultatit të një zone zgjedhore, sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor, fillon vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të Kodit Zgjedhor. KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime administrative të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim të KZAZ-së, sipas nenit 122 apo, sipas rastit, të Komisioneri sipas nenit 123 të Kodit Zgjedhor për rezultatin dhe/ose pavlefshmërinë e votimit.

2. Kur për të njëjtën zonë zgjedhore janë paraqitur në KAS disa ankime administrative dhe kur të paktën njëri prej tyre ka në objekt pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor, KAS merr në shqyrtim fillimisht pretendimin për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në ato qendra votimi. Vendimi i KAS për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, sipas nenit 160 të Kodit Zgjedhor, është vendim i ndërmjetëm dhe mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor bashkë me vendimin e KAS që zgjidh ankimin e paraqitur sipas nenit 124 të Kodit Zgjedhor.

3. Vendimi i KAS për bashkimin e ankimeve administrative është i formës së prerë.

4. Vendimi i KAS për bashkimin e ankimeve administrative shpallet për publikun në hyrjen e selisë së KQZ-së jo më vonë se dy orë pas marrjes së tij.

### Neni 20

#### Palët në shqyrtimin administrativ

1. Në shqyrtimin e ankimit administrativ nga KAS-i kanë të drejtë të marrin pjesë, duke paraqitur kërkesa, duke ngritur pretendime, duke bërë prapësime të pretendimeve të ngritura, si dhe duke paraqitur prova vetëm:

a) ankuesi;

b) pala e interesuar. Palë e interesuar është çdo subjekt zgjedhor, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, preken ose kanë të ngjarë të preken nga vendimi që mund të jepet në përfundim të procedurës administrative.

1. Pala e interesuar depoziton kërkesën e saj për të marrë pjesë në shqyrtimin e një ankimi administrativ, jo më vonë se ora e caktuar për zhvillimin e seancës. Depozitimi jashtë këtij afati passjell mospranimin e kërkesës.

2. Pranimi i palës së interesuar në procedurën administrative bëhet me vendim të KAS-it në fillim të seancës përkatëse dhe pas verifikimit të pjesëmarrjes së palëve të tjera.

4. Palët kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë procedurës administrative nga përfaqësues të autorizuar prej tyre ose me deklaram në seancë. Subjektet zgjedhore të përfaqësuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si rregull, përfaqësohen nga përfaqësuesit e akredituar të tyre në KQZ.





## Neni 21 Shqyrtimi administrativ

1. Shqyrtimi administrativ për ankimin administrativ zhvillohet nga KAS-i në seancë publike.
2. Relatori i caktuar me short sipas parashikimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje drejton seancën e KAS-it.
3. Afatet për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KAS-i në konsultim me palët.
4. Shqyrtimi i ankimit administrativ përpara KAS-it bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrajnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes.
5. Gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ mbahet procesverbal nga struktura përkatëse e KQZ-së dhe, për sa është e mundur, seanca regjistrohet me zë dhe/ose me figurë. Në procesverbal shënohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e palëve dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë provat që merren, si dhe vendimet e ndërmjetme të KAS-it.

## Neni 22 Çelja e seancës për shqyrtimin e ankimit administrativ

1. Në ditën dhe në orën e caktuar palët njoftojnë administratën e KQZ-së për praninë e tyre.
2. Përpara fillimit të seancës, administrata e KQZ-së thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton të zënë vendet e caktuara.
3. Pasi deklarohet çelja e seancës së shqyrtimit, verifikohet legjitimitimi procedural i palëve, sipas nenit 133 të Kodit Zgjedhor.
4. Në qoftë se në ditën dhe në orën e caktuar njëra ose disa prej palëve nuk paraqiten, seanca zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së tyre.
5. Përpara se palët të paraqesin pretendimet e tyre, KAS-i:
  - a) pranon ose refuzon deklaratimet individuale të anëtarëve të KAS-it për ekzistencën e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të nenit 16 të kësaj rregulloreje;
  - b) vendos lidhur me kërkesat e palëve për përjashtimin e anëtarëve të KAS-it për ekzistencën e konfliktit të interesit sipas parashikimeve të nenit 16 të kësaj rregulloreje;
  - c) vendos lidhur me kërkesat e palëve apo të relatorit për mosshqyrtimin e çështjes për mungesë kompetence të KAS-it ose kalim të afatit për ankimim.
6. Pasi merr vendim për kërkesat paraprake të palëve dhe në rast se ato nuk sjellin pushimin e shqyrtimit administrativ, KAS-i shqyrton dhe zgjidh çështjen në themel, pa ndërprerë seancën. Seanca ndërpritet vetëm kur është e nevojshme marrja e provave nga të tretë.





**Neni 23**  
**Paraqitja e pretendimeve dhe kërkimi i provave**

1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 135 të Kodit Zgjedhor, KAS-i, fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:

- a) të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;
- b) të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile; dhe
- c) të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.

2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KAS-i, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit.

3. Secili anëtar i KAS-it ka të drejtë që gjatë hetimit administrativ të marrë kryesisht, pa debat dhe as votim, prova që janë në administrim të KQZ-së. KAS-i është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara.

4. KAS-i mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 136 të Kodit Zgjedhor, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KAS-it për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin përfundimtar. KAS-i nuk mund të refuzojë kërkesën për prova, të bërë sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Paraqitja e pretendimeve të palëve fillon me ankuesin dhe vijon me palët e interesuara, sipas radhës së caktuar nga drejtuesi i seancës së KAS-it. Kjo radhë ruhet gjatë gjithë procedimit.

6. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KAS-i çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor.

**Neni 24**  
**Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova**

1. KAS, nëpërmjet Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.

2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe brenda afatit të përcaktuar në të.

3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, KAS-i në përputhje me nenin 172 të këtij Kodi dhe pas njoftimit nga Komisioneri gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës.





## Neni 25 Këqyrja e materialit zgjedhor

1. Për nevojat e hetimit administrativ, KAS-i, kur ka pranuar kërkesën e palëve apo sipas parashikimeve të nenit 136 pika 3 të Kodit Zgjedhor, këqyr dokumentacionin dhe materialin zgjedhor që ndodhet në kutinë e materialeve të votimit dhe/ose kutitë e votimit dhe fletët e votimit, si dhe çdo dokumentacion apo material tjetër zgjedhor. Kur materiali zgjedhor ndodhet brenda kutive me vula sigurie, hapja dhe rimbyllja e tyre bëhet sipas procedurave që parashikon Kodi Zgjedhor për hapjen dhe mbylljen e kutive, duke treguar dhe shënuar kodet me të cilat kutitë përkatëse janë mbyllur nga KZAZ-ja, si dhe numrat me të cilat ato mbyllen rishtazi.

2. Këqyrja e materialit zgjedhor bëhet në prani të palëve dhe publikut. Pas këqyrjes së materialit dhe/ose dokumentacionit zgjedhor, palët kanë të drejtë të paraqesin vlerësimet dhe pretendimet e tyre. Provat e gjetura paraqiten në procesverbalin e mbledhjes së KAS-it.

3. KAS-i, me kërkesë të palëve ose kryesisht, kur çmon se për dhënien e vendimit është i nevojshëm rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara, kryen, në praninë e palëve, rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave dhe pasqyron përfundimin në procesverbalin e mbledhjes së KAS-it dhe vendimin përkatës të saj. Vota të caktuara janë votat e identifikuar ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të Kodit Zgjedhor. Secili anëtar ka të drejtë të kërkojë dhe KAS është i detyruar të kryejë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara në kuadër të kësaj procedure, me mbështetjen e administratës së KQZ-së.

4. Kur objekt i ankimit janë kutitë e votimit, të konstatuara si “KUTI TË PARREGULLTA” nga KZAZ-ja, sipas nenit 115 të Kodit Zgjedhor, hetimi administrativ është i detyrueshëm sipas parashikimeve të nenit 123/2 të Kodit Zgjedhor, gjatë shqyrtimit të ankesës për atë zonë zgjedhore, në përputhje me nenin 124 të Kodit Zgjedhor. Hetimi nuk kufizohet vetëm në këqyrjen nga jashtë të kutisë, duke vlerësuar në tërësi faktet dhe rrethanat që kanë çuar në konstatimin e kutisë si “KUTI E PARREGULLT”, por edhe nëse këto parregullsi kanë ndikuar në materialin zgjedhor. Nëse KAS-i kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor, shprehet me vendim se janë kuti të rregullta, KAS-i kryen numërimin fillestar të votave në këto kuti. Votimi në qendrat e votimit, kutia/kutitë e të cilave janë konstatuar si “KUTI TË PARREGULLTA”, sipas nenit 115 të Kodit Zgjedhor dhe për të cilat nuk është bërë ankim, sipas nenit 124, konsiderohet i pavlefshëm.

5. Vendimet sipas pikave 3, 4 të këtij neni, mund të ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar të KAS-it.

## Neni 26 Faktet e njohura botërisht dhe ekspertimet

1. Për faktet, të cilat janë të njohura botërisht, si dhe për ato fakte, të cilat janë të ditura për KAS-in, për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim. Gjatë hetimit administrativ të çështjes, KAS-i konfirmon në seancë njohjen dhe marrjen parasysh të tyre në shqyrtimin e çështjes.





2. Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e ankimeve administrative, kërkohen njohuri të posaçme në fusha të shkencës ose teknikës, KAS-i mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë.

### **Neni 27** **Prapësimet mbi provat**

1. Palët në shqyrtimin administrativ kanë të drejtë të paraqesin prapësimet e tyre për të kundërshtuar:

- a) mënyrën e marrjes së provave të paraqitura nga palët e tjera;
- b) faktet që tregojnë këto prova; ose
- c) vërtetësinë dhe besueshmërinë e fakteve që tregojnë këto prova.

2. Në mbështetje të këtyre prapësimeve, palët kanë të drejtë të paraqesin edhe prova të tjera, përveç atyre të kërkuara, sipas nenit 136 të Kodit Zgjedhor.

### **Neni 28** **Mbyllja e hetimit administrativ**

1. Kur gjatë hetimit administrativ kanë dalë fakte apo prova të reja, për të cilat ankuesi nuk mund të kishte dijeni përpara se të paraqitej ankimi, objekti i ankimit mund të shtohet apo ndryshohet përpara se KAS-i t'i japë fund hetimit administrativ, sipas pikës 2 të këtij neni. Kërkesa mund të përfshijë ndryshimin e tabelës së rezultatit ose pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra votimi të caktuara. KAS-i është i detyruar të marrë në shqyrtim pretendimin e ri dhe të rihapë hetimin administrativ.

2. Pas përfundimit të hetimit administrativ, KAS-i pyet palët nëse kanë kërkesa ose prova të tjera në dobi të shqyrtimit të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen, KAS-i i jep fund hetimit administrativ dhe i fton palët të parashtrajnë pretendimet përfundimtare.

3. KAS-i vendos, rast pas rasti, nëse palët do t'i parashtrajnë pretendimet përfundimtare me shkrim ose me gojë.

### **Neni 29** **Tërheqja e pretendimeve ose heqja dorë prej tyre**

Ankuesi ka të drejtë të heqë dorë tërësisht apo pjesërisht nga objekti i ankimit në çdo fazë të shqyrtimit të tij. Në këtë rast KAS-i vendos pushimin e çështjes në tërësi ose për pjesën që është hequr dorë. Pas kësaj ankuesi nuk mund të paraqesë përsëri ankimin, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes.

### **Neni 30** **Vendimet që merr Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve**

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KAS vendos sipas rastit:

- a) pushimin e shqyrtimit;
- b) lënien në fuqi të vendimit të KZAZ-së/ Komisionerit;
- c) ndryshimin e vendimit të KZAZ-së/Komisionerit;
- ç) shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore;





d) lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve, sipas nenit 122 ose nenit 123 të Kodit Zgjedhor.

2. KAS-i merr vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij.

3. KAS-i merr vendim përfundimtar, në lidhje me ankimin ndaj vendimit për miratimin e tabelës së rezultateve të zgjedhjeve, jo më vonë se 10 ditë nga data kur është regjistruar ankimi përkatës. Në çdo rast tjetër, KAS-i merr vendim jo më vonë se dy ditë nga paraqitja e ankimit.

4. Në rastin e bashkimit të kërkesave ankimore, afatet llogariten nga data e regjistrimit të kërkesës së fundit ankimore.

5. Me deklarin e përfundimit të çështjes, drejtuesi i seancës i jep fjalën relatorit të çështjes vijuese të përcaktuar sipas shortit të hedhur në përputhje me parashikimet e nenit 15 të kësaj rregulloreje.

### Neni 31

#### Përmbajtja e vendimeve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

1. Vendimi i KAS-it është gjithmonë i formës së shkruar.

2. Vendimet e KAS-it për ankimet zgjedhore përmbajnë:

- a) palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ;
- b) kërkimet e secilës palë;
- c) tregimin e çdo prove të marrë në shqyrtim;
- ç) shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga këto prova;
- d) analizën ligjore të çështjes; dhe
- dh) pjesën urdhëruese.

3. Vendimi i KAS-it përmban numrin, datën, përkatësisht orën e shpalljes së tij, si dhe nënshkrimet e anëtarëve të KAS-it, së bashku me deklarin e votës.

4. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga anëtarët që e mbështesin atë.

5. Vendimi përmban edhe sqarimin për të drejtën e palëve për ta ankimuar në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit.

6. KAS-i në asnjë rast nuk nxjerr vendime që nuk përmbajnë të gjitha elementet e përmendura në këtë nen.

7. Vendimi i KAS-it duhet të arsyetohet nga relatori i çështjes i asistuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi hartohet në 3 kopje.

8. Të gjitha kopjet e vendimit nënshkruhen nga anëtarët e KAS-it. Vendimi i njoftohet ankuesit, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, subjekteve të tjera të prekura dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.



**Neni 32**  
**Përfaqësimi në Kolegjin Zgjedhor**

1. Kur ndaj vendimeve të KAS-it bëhet ankesë në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, përfaqësimi bëhet nga struktura që trajton çështjet ligjore pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Përfaqësuesit e KQZ-së paraqesin aktet dhe provat e administruara në fashikullin e shqyrtimit të ankimit administrativ, prapësimeve dhe konkluzioneve duke iu referuar procesverbalit të seancës dhe argumentimit të vendimit.

**Neni 33**  
**Arkivimi i dokumentacionit**

1. KQZ krijon arkivin për të gjithë dokumentacionin për çdo ankim në përputhje me rregullat mbi arkivat.

2. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kujdeset për krijimin e arkivit për të gjithë dokumentacionin për çdo ankim në përputhje me rregullat mbi arkivat.

**SEKSIONI 2**  
**PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NGA KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

**Neni 34**  
**E drejta për të vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve**

1. Komisioneri i kërkon Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve:

a) vendosjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim;

b) vendosjen e sanksioneve administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

**Neni 35**  
**Forma dhe përmbajtja e kërkesës për sanksione dhe masa disiplinore**

1. Në çdo rast kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas parashikimit të nenit 34 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

a) Referimin për procedurën konkrete për hetimin administrativ mbi të cilën paraqitet kërkesa;

b) Bazën ligjore;





- c) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar, rrethanat e kryerjes së shkeljes/parregullsisë/kundërvajtjes;
- ç) të dhëna nëse shkelësi rezulton përsëritës për shkeljen;
- d) rëndësinë e shkeljes/parregullsisë/kundërvajtjes;
- dh) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi;
- e) Dokumentin/provat që vërtetojnë kryerjen e shkeljes ose parregullsisë/kundërvajtjes;
- f) masën/sanksionin konkret të propozuar.

### Neni 36

#### Regjistrimi i kërkesave të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

1. Kërkesat e Komisionerit drejtuar KAS-it për marrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim, depozitohen dhe regjistrohen menjëherë në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore që administrohet nga Zyra përkatëse e KQZ-së.

2. Regjistri i kërkesave për masat disiplinore përmban edhe:

- a) numrin rendor të kërkesës ankimore;
- b) datën dhe orën e paraqitjes së kërkesës;
- c) objektin e kërkesës;
- ç) identitetin e subjektit ndaj të cilit kërkohet masa disiplinore;
- d) shkeljen e kryer, duke referuar në dispozitën ligjore ku mbështetet kërkesa
- dh) listën e dokumenteve që i bashkëlidhen kërkesës;
- e) masën që propozohet.

3. Kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatët e tyre që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet, depozitohen dhe regjistrohen menjëherë në regjistrin e posaçëm për Sanksionet Administrative.

4. Regjistri i Sanksioneve Administrative Zgjedhore, përmban edhe:

- a) numrin rendor të kërkesës për sanksion administrativ;
- b) datën dhe orën e paraqitjes së kërkesës;
- c) objektin e kërkesës;
- ç) identitetin e subjektit ndaj të cilit kërkohet masa disiplinore;
- d) shkelja e kryer, duke referuar në dispozitën ligjore ku mbështetet kërkesa
- dh) listën e dokumenteve që i bashkëlidhen kërkesës;
- e) masën që propozohet.

5. Zyra përkatëse e KQZ-së ia përcjell menjëherë kërkesën ankimore Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe anëtarëve të KAS. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vë në lëvizje KAS-in nëpërmjet njoftimit të tij mbi kërkesën dhe njofton Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së. Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me strukturën që trajton çështjet ligjore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përgatit organizimin e seancës për hedhjen e shortit për caktimin e relatorit sipas parashikimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.



Handwritten signatures in blue ink, including the signature of the Chairman of the Central Election Commission.



### Neni 37

#### **Caktimi i seancës për përgatitjen e shortit dhe zhvillimi i shortit**

Me marrjen e kërkesës sipas parashikimeve të nenit 36 të kësaj rregulloreje, KQZ kryen të gjitha veprimet e parashikuara përkatësisht në nenet 12 dhe 13 të kësaj rregulloreje si dhe zhvillon shortin sipas parashikimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

### Neni 38

#### **Afati i shqyrtimit**

Shqyrtimi i sanksioneve administrative apo vendosjes së masave disiplinore nga KAS-i për shkelje, parregullsi apo kundërvajtje, bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të tyre, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së tyre.

### Neni 39

#### **Përjashtimi**

1. Anëtari i Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve nuk mund të jetë relator dhe nuk merr pjesë gjatë shqyrtimit dhe në vendimmarrjen mbi një kërkesë administrative për masë disiplinore/sanksion, kur ai gjendet në një nga rastet e pengesave ligjore të parashikuara në nenin 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, apo të konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2. Nëse anëtari i KAS-it ndodhet në kushtet e pengesave ligjore apo rastet e konfliktit të interesave zbatohen dhe ndiqen të gjitha parashikimet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.

### Neni 40

#### **Shqyrtimi**

1. Shqyrtimi administrativ për kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve zhvillohet nga KAS-i në seancë publike.

2. Relatori i çështjes i caktuar sipas shortit të zhvilluar në përputhje me parashikimet e nenit 37 të kësaj rregulloreje, është drejtuesi i seancës së KAS-it për shqyrtimin e kërkesës për masë disiplinore/sanksion.

3. Afatet për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KAS-i në konsultim me palët.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mbahet procesverbal nga strukturat përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe seanca regjistrohet me zë dhe/ose me figurë. Në procesverbal shënohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e palëve dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë provat që merren, si dhe urdhrat e vendimet e ndërmjetme të KAS-it.





#### Neni 41

### Procedura administrative për shqyrtimin e kërkesës për masë disiplinore/sanksion nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

1. KAS-i shqyrton kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për masë disiplinore/sanksion në seancë publike duke zbatuar parashikimet e dispozitave të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” në tërësi dhe veçanti në lidhje me:

- a) Kreu I, Pjesa e katërt, “Pjesëmarrja në procedurën administrative”,
- b) Kreu II “Parashikime të përgjithshme mbi procedurën administrative;
- c) Kreu III “Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative”;
- d) Kreu V “Afatet”;
- e) Kreu VII “Çështjet paraprake dhe vendimet e ndërmjetme”
- f) Kreu X “Hetimi administrativ”
- g) Kreu XI “Përfundimi i procedurës administrative”

#### Neni 42

### Detyrimi i organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova

1. KAS nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.

2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së Komisioneri dhe brenda afatit të përcaktuar në të.

3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, KAS-i në përputhje me nenin 172 të këtij Kodi dhe pas njoftimit nga Komisioneri gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës.

#### Neni 43

### Përfundimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë të Komisionerit, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen. Në vendimin përfundimtar për çështjen, KAS-i vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë saj.

2. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të Kodit të Procedurave Administrative. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.

#### Neni 44

### Afati për përfundimin e procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur brenda afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

2. Në rastet kur Kodi Zgjedhor nuk parashikon afate, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.



**Neni 45**  
**Vendimet që merr Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

1. Në përfundim të shqyrtimit administrativ KAS-i vendos sipas rastit:
- a) pushimin e shqyrtimit të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
  - b) rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
  - c) pranimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
  - ç) pranimin e pjesshëm ose ndryshimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve.
2. KAS-i merr vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, pavarësisht nga ajo çfarë Komisioneri ka kërkuar.

**Neni 46**  
**Përmbajtja e vendimeve të Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

1. Vendimi i KAS-it është gjithmonë i formës së shkruar.
2. Vendimet e KAS-it për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përmbajnë edhe:
- a) emrin e organit që nxjerr aktin;
  - b) palët të cilave u drejtohet akti;
  - c) datën e miratimit;
  - ç) bazën ligjore;
  - d) pjesën arsyetuese;
  - dh) dispozitivin që tregon pjesën urdhëruese dhe kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
  - e) kërkimet e secilës palë;
  - ë) tregimin e çdo prove të marrë në shqyrtim;
  - f) shpjegimin e rrethanave dhe fakteve që kanë rezultuar nga këto prova;
  - g) analizën ligjore të çështjes;
  - gj) të drejtën e palëve për të ankimuar vendimin në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit.
2. Vendimi i KAS-it përmban numrin, datën, përkatësisht orën e shpalljes së tij, si dhe nënshkrimet e anëtarëve të KAS-it, së bashku me deklarinimin e votës.
3. Vendimi shoqërohet me mendimin e pakicës ose mendimin alternativ të nënshkruar nga anëtarët që e mbështesin atë.
4. Vendimi i Komisionit duhet të arsyetohet nga Relatori me mbështetjen e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Vendimi hartohet në 3 kopje. Të gjitha kopjet e vendimit nënshkruhen nga anëtarët e KAS-it.
6. Vendimi i njoftohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe palëve të tjera në proces.





**Neni 47**  
**Përfaqësimi në Gjykatë**

1. Kur ndaj vendimeve të KAS-it bëhet ankim, përfaqësimi në gjykatë bëhet nga struktura që trajton çështjet ligjore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Përfaqësuesit e KQZ-së paraqesin prapësimet, konkluzionet si dhe aktet dhe provat e administruara në dosjen e çështjes së shqyrtuar nga KAS.

**KREU V**  
**DOKUMENTACIONI I KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

**Neni 48**  
**Arkivimi i dokumentacionit**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon arkivin për të gjithë dokumentacionin për çdo kërkesë në përputhje me rregullat mbi arkivat.
2. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kujdeset për krijimin e arkivit për të gjithë dokumentacionin për çdo ankimim në përputhje me rregullat mbi arkivat.

**Neni 49**  
**Ruajtja dhe administrimi elektronik i materialeve të seancave**

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për procesin e ruajtjes dhe administrimit të materialeve të seancave edhe në formatin elektronik.
2. Materialet e seancave, ruhen në një bazë elektronike të dhënash, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

**Neni 50**  
**Regjistrimi i akteve dhe i dokumentacionit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve**

1. Regjistrimi i akteve dhe dokumenteve bëhet në regjistrat e poshtëshënuar:
  - a) Regjistri i ankimeve;
  - b) Regjistri i kërkesave për sanksione;
  - c) Regjistri i kërkesave për masa administrative;
  - ç) Regjistri i vendimeve të KAS-it.
3. Modeli i regjistrave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Administrimi i regjistrave bëhet nga struktura përkatëse pranë administratës së KQZ-së.





## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 51

#### Zhvillimi i seancave nëpërmjet mjeteve të Komunikimit Elektronik

1. Në rastet e masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjëndjes së jashtë zakonshme, gjëndjes së fatkeqësisë natyrore apo situatave të pandemive, mbledhjet e komisionit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Drejtuesi i seancës në bashkëpunim me administratën e bën të mundur përgatitjen e infrastrukturës.

2. Sistemi i konferencave duhet të mundësojë identifikimin e palëve nëpërmjet transmetimit audio-video dhe regjistrimin e seancave. Palët regjistrohen në platformën e posaçme që menaxhohet nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe marrin akses për seancën dhe mund të paraqesin kërkesat apo pretendimet e tyre në seancë.

### Neni 52

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.









Kërkesë ankimore

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Lined area for providing facts, arguments, and legal provisions supporting the appeal.



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

Kërkesë ankimore

PROVAT QË PARAQITEN  
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

Lined writing area for providing evidence and references.

Bashkëlidhur Vendimi nr. \_\_, date \_\_. \_\_. 20\_\_

ANKUESI



Handwritten signatures and date: \_\_/\_\_/20\_\_